

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Programi Model i Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore

Për shkak të rëndësisë që paraqet transparenca në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i ka dedikuar një model të veçantë programit të transparencës të këtyre autoriteteve publike duke miratuar me Urdhrin nr. 211/2018 “Programin Model të Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Programi model është hartuar në përputhje me parashikimet në nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore,

Programi Model i Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore synon të bëjë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm, të gjitha kategoritë e informacionit, duke i ardhur kështu në ndihmë jo vetëm qytetarëve, por dhe vetë autoriteteve publike për një qasje më të hapur me publikun.

Në këtë optikë, Programi Model i Transparencës i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore është ndarë në 7 fusha kryesore: “Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë”; “Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare”; “Për kërkesat për informim”; “Mbi shërbimet që ofron bashkia”; “Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore”; “Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje” dhe “Informacion tjetër”.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 03 - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Vendim Nr. 04 - Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

Vendim Nr. 05 - Agjencia e Zhvillimit të Territorit

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit mars 2022, ka dhënë 3 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Me anë të vendimit nr. 3 datë 17.03.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Kërkuesi ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

Numrin e pikave/qendrave të shërbimi të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SH.A (në vijim "OSHEE Group" SH.A) të cilat ndodhen në territorin e Shqipërisë;

Numrin e stafit të "OSHEE Group" SH.A, që ofron shërbim për publikun në sportele;

Statusi i pronësisë së godinave që ofron shërbim për publikun. Sa godina janë në pronësi të "OSHEE Group" SH.A dhe sa janë marrë me qira nga një subjekt privat;

Sa është kostoja totale e qirasë vjetore që paguan "OSHEE Group" SH.A për mjediset e shërbimit? Kosto totale e qiramarrjes për 5 vitet e fundit, të specifikuar sipas secilit viteve, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021.

Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje për pikën e 1 të kërkesës ndërkohë për pikat e tjera ka sqaruar se: "...Informacioni i kërkuar nuk konsiderohet informacion publik referuar dispozitave të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", neni 7, por është informacion i cili lidhet ngushtësisht me aktivitetin financiar, përhapja e të cilit cënon interesat ekonomike dhe tregtare të shoqërisë. Gjithashtu, të gjitha të dhënat që klasifikohen si të dhëna publike sipas ligjit të sipërcituar, ndër të cilat edhe Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit me adresat e tyre të sakta, mund t'i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të internetit të autoritetit publik.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË nga SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se, lidhur me pikën 1, të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion linkun përkatës në të cilën ndodhet informacioni i kërkuar.

Ndërkohë, lidhur me pikat 2, 3 dhe 4 të kërkesës për informacion, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në shkronjën b) të pikës 1 të nenit 2, të LDI parashikohet se: "Autoritet publik" b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike".

Në kuptim të këtij parashikimi, "OSHEE Group" SH.A, është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës, pavarësisht se informacioni i prodhuar është si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, legjislacion i cili nuk parashikon përjashtimin e "OSHEE Group" SH.A nga zbatimi i detyrimeve që burojnë nga LDI.

Nga shqyrtimi i kërkesës për informacion, Komisioneri vlerëson se, një pjesë e informacionit të kërkuar në pikën 2 të kërkesës për informacion përfshihet në kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Ndërkohë, pikat 3 dhe 4 të kërkesës për informacion përfshihen në kategorinë e informacioneve që në kuptim të LDI, mund të vendoset në dispozicion nga Autoriteti Publik vetëm mbi bazën e një kërkesë.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesës, KDIMDP vendosi urdhërimin e pjesshëm të Autoritetit Publik për dhënie të informacionit të kërkuar duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

"Ditët e Transparencës" me Autoritetet Publike të Qarkut të Lezhës

Transparenca proaktive e Autoriteteve Publike është ndër faktorët e garantimit të të drejtës për akses në informacionin publik, duke ndikuar në konsolidimin e një administrate dinamike në ofrimin e shërbimeve.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nisi nga Lezha zbatimin e iniciativës "Ditët e Transparencës". Në këtë takim morën pjesë Prefekti i Qarkut, z. Gjokë Jaku, Kryetari i Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu, drejtues/përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore të këtij qarku, të drejtorive rajonale të institucioneve qendrore të varësisë dhe koordinatorët e tyre për të drejtën e informimit. Kultura e transparencës forcohet jo vetëm nga përmbushja e detyrimeve rregullatore, por edhe nëpërmjet bashkëpunimit efektiv me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në fokus të takimit ishte vlerësimi i ecures së zbatimit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" nga Autoritetet Publike. Nga monitorimi dhe analiza e situatës, Zyra e Komisionerit vlerëson se kërkohet një frymë e re për përditësimin e vazhdueshëm të Programit të Transparencës dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve, veçanërisht, për shpenzimet buxhetore, procedurat e prokurimit publik apo auditimet. Njëkohësisht, u kërkua nga koordinatorët rritja e cilësisë në procesin e trajtimit të kërkesave për informacion për qytetarët apo grupet e interesit.



Konsultimi për përmirësimet në ligjin “Për të drejtën e informimit”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkëorganizoi me organizatën “Lëviz Albania” tryezën konsultuese për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit””.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, medias dhe koordinatorë të të drejtës për informim të institucioneve qendrore, të pavaruara e të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në takim u vlerësua ecuria e përgjithshme në përmbushjen e detyrimeve të ligjit 119/2014, në ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, në nxitjen e kulturës së transparencës dhe në rritjen e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së Autoriteteve Publike. Problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të tij, por dhe sugjerimet e organizatave të shoqërisë civile sollën domosdoshmërinë e përmirësimeve/ndryshimeve në legjislacion.

Ndër më kryesoret janë:

- konsolidimi i rolit, funksioneve dhe kompetencave të Zyrës së Komisionerit;
- krijimi i një Bordi Këshillimor si një mekanizëm rekomandues mbi zbatimin sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të ligjit;
- përfshirja në Programin e Transparencës të vendimmarrjes së organeve të prokurorisë për veprat penale që kanë interes të lartë publik;
- mundësinë e sanksionimit të personit përgjegjës për refuzimin e dhënies së informacionit, përveç rasteve kur përgjegjës është koordinatori;
- përfitimin e një shtesë page për natyrë të veçantë pune për koordinatorin për të drejtën e informimit.

Në këtë tryezë u diskutua gjerësisht për propozimet në projektligj me synim shtrirjen e konsultimit në nivel teknik dhe zgjerimit të pjesëmarrjes së aktorëve/grupeve të interesit në këtë proces.